

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.791-3/2016 të dt. 07.11.2016, pas mbajtjes së seancës kryesore gjyqesore, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **09.10.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. S., nga i ati N., e ëma V., e vajzërisë A., i lindur më dt. në fshatin Jabllanice, tani me banim ne Prizren, rr. “ ” pn, i martuar baba i 4 femijeve, ka të kryer shkollen e mesme ekonomike, eshte i gjendjes se meseme ekonomike, i pa pune, pronar i ndermarrjes ndertimore, boshnjak, shtetas i R. së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt.13.07.2015, rreth ores 21,45 min, ne Prizren, ne rr. “ ”, i pandehuri S. S., me dashje perdore forcen ndaj te demtuarit-te mitur A. R. ne ate menyre qe pasi nje konflikti te meparshem ne mes djalit te te pandehurit dhe te demtuarit, i pandehuri e kap per fytyre duke ja shtrenguar fytyren dhe me pas ia terheq veshet, duke i thene “A ti djali i A. a?”.

-kësodore ka kryer veprën penale te sulmit nga neni 187 par.1 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41, 46, 49 p.1.1, 50, 51, 73, 74, 75, 76 dhe 365 të KPK-ës, te akuzuarit i shqipton,

D E N I M M E G J O B Ë

Ne lartesi prej **150/njeqindepesedhjete/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 7 dite burgim.

D E N I M M E K U S H T

Duke i vertetuar denimin me burgim në kohëzgjatje **prej 3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej **1 (nje) viti**, nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, i akuzuari nuk do te kryene ndonjë vepër të re penale.

I akuzuari obligohet qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedures penale si dhe ato te paushallit gjyqesor ne shumen prej **30,00 euro**, ne afat prej 15 diteve pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr. 791-3/2016 te dt.07.11.2016, kunder te akuzuarit S. . . . S' . . . nga Prizreni, per shkak te vepres penale sulmit nga neni 187 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimet te fajesis per vepren penale e cila i vihete ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, te sulmit nga neni 187 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin i shpalli fajtores dhe i shqiptoi denimin me kusht, paraprakisht duke i vertetuar pergjegjesin e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjelljen korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pa gjykuar, si dhe ne kuptim te nenit 74, 75 e 76 gjykata morri per baze faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tij ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka shprehur keqardhje per shkak te vepres se kryer, ka pasur sjellje korrekte ne gjykate, te demtuarit i ka kerkuar falje dhe e ka gjetur gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, eshte i pa pune, i gjendjes se dobet ekonomike, babai i 4 femijeve, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe dhe me kusht sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, prandaj i shqipton gjobe dhe denimin me burgim ne kohezgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti, nese i akuzuari nuk kryene veper te re penale, nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk kryen ndonje veper te re penale, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451,te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2440/16/2015 të dt. 09.10.2017

**Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari
Fatmir Krasniqi**



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi palet e pakenaqura kanë të drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate